



ZYRA E PROKURIMIT

07 NR 312-5820/18

Me 03,09, 2018

**KONTRATA , KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA**

**PJESAI: KONTRATA NR. 066/2018**

**KOMUNA KLINE** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), qe perfaqesohet nga Menaxheri i Prokurimit z. Abaz Foniqi në njërën anë;

dhe

**TECO – SHPK** “ (në vazhdim “Operatori Ekonomik”),RRUGA NDUE PERLLESHI 10.000 PRISHTINE me numer biznesi 810071465 dhe numer fiskla 810071565 qe perfaqesohet nga KUSHTRIM ALIHAJDARAJ – PRONAR

.Ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

**FURNIZIM INSTALIM DHE MONTIM I KAMERAVE NE SHKOLLA DHE QKMF “NENE TEREZA NE KLINA**

**me numër Identifikues 634-18-5074-131/ 634-18-060-136**

Neni 1 Lënda

**1.1 Lënda e kontratës do të jetë kontrate publike**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë FURNIZIM –INSTALIM DHE MONTIM nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

përshkrimi i përgjithshëm i furnizimeve, pjesë dhe Specifikimi i detyrueshem teknik

Nr.	MODELI	Përshkrimi
1	Kamera	3 MP, 3MP CMOS Sensor, 18 fps at 1920*1536 resolution, EX 40m IR, Outdoor EXIR Bullet, ICR, 0.01 Lux/F1.2, 12 VDC, Srr IR, DNR, OSD Menu (Up the Coax), IP66, 2.8 mm Lens. Apo Kompatibil Minimumi i specifikimeve
2	DVR 8ch	DVR 8 kamera DVR 8ch, 3 Megapixel për kanal Apo Kompatibil Minimumi i specifikimeve
3	HDD 1TB	SATA 6Gb/S, 64MB Cache. Apo Kompatibil

		Minimumi i specifikimeve
4	MSE246	Adapter për furnizim me rrymë për 10 kamera.  Apo Kompatibil Minimumi i specifikimeve
5	BNC-HEX	RG-59 BNC KonektorHexagonal, materiali zinku Apo Kompatibil Minimumi i specifikimeve
6	Kuti OG	Kuti OG për mbrojtje nga shiu të konektorëve dhe rymës
7	Monitor kamera	Monitor 21" Led për vëzhgimin e kamerave. Apo Kompatibil Minimumi i specifikimeve
8	Gyp plastik	Gyp për kabullë për kamera
9	EURO 22	Kabullë për kamera

## **Neni 2 Kushtet e dërgesës**

**2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 10 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.**

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë KLINE.

2.3 Inkotermi<sup>1</sup> i zbatueshëm do të jetë *DDP Kline*

## **Neni 3 Origjina**

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.- edhe ne Specifikacioni Teknik të Dorzuar me oferte që është pjesë integrale e kësaj kontrate .

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

3.3. Paisjet duhet të kenë Garancion për cilësi 12 muaj .

<sup>1</sup> Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.4. Garancioni te jipet me shkrim dhe te Shoqerohet me Siguracion nga Banka apo Kompani sigurimi para se te Behet pagesa apo do te behet ndalje e paras ne vlere 10 % nga Vlera e kontrates per afatin e garancionit te paisjeve .

Neni 4

Çmimi

**Pjesa 1- ne shkolla**

Nr. i Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njes DDP <sup>2</sup> - €	Çmimi total €
1.	Kamera	cope	24	40.00	960.00
2.	DVR 8ch	cope	5	129.00	645.00
3	HDD 1TB	cope	5	42.00	210.00
4	Adapter për furnizim me rrymë për 10 kamera	cope	5	10.00	50.00
5	BNC KonektorHexagonal, materiali zinku	cope	48	1.00	48.00
6	Kuti OG për mbrojtje nga shiu të konektorëve dhe rymës	cope	24	2.00	48.00
7	Monitor për kamera	cope	5	120.00	600.00
8	Gyp për kabullë për kamera	m	1200	0.35	420.00
9	Kabullë për kamera	m	1200	0.35	420.00
<b>Totali i Përgjithshëm:</b>					<b>3.401.00</b>

Pjesa 2- ne QKMF NENE TERZA NE KLINE

<sup>2</sup> Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare.

Nr. i Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi nj DDP <sup>3</sup> -	Çmimi total €
1.	Kamera	cope	8	35.00	280.00
2.	DVR 8ch	cope	1	90.00	90.00
3	HDD 1TB	cope	1	42.00	42.00
4	Adapter për furnizim me rrymë për 10 kamera	cope	1	10.00	10.00
5	BNC Konektor Hexagonal, materiali zinku	cope	2	2.00	4.00
6	Kuti OG për mbrojtje nga shiu të konektorëve dhe rymës	cope	1	2.00	2.00
7	Monitor për kamera	cope	1	120.00	120.00
8	Gyp për kabullë për kamera	m	200	0.35	70.00
9	Kabullë për kamera	m	200	0.35	70.00
<b>Totali i Përgjithshëm:</b>					688.00

**4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 4.08900 €; katërmijetëdhjetëneqetëuro Euro.**

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

## **Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

<sup>3</sup> Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare.

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 6 Komunikimet


6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE <sup>4</sup> në kater origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

6.5. Menaxhimi i kontrates me vendim do te behet nga Zyrtari i T. I. Z. Haalil Bekaj

Për Autoritetin Kontraktues Komuna Kline		Per Kontraktuesin : TECO SHPK -Prishtine	
Emri:	ABAZ FONIQI	Për Furnizuesin	Kushtrim Alihajdaraj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Emri:	<i>Kushtrim Alihajdaraj</i>
Nënshkrimi:		Pozita:	
Data:	03.09.2018	Nënshkrimi:	
Vula:		Data:	03.09.2018

<sup>4</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.